



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
SEKTORI I PROKURIMEVE

Durrës, më 09.10.2024

PROCESVERBAL
Tipi i kontratës – Shërbim

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Studim projektimi i projekteve prioritare të infrastrukturës publike në Bashkin e Durrësit ”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): Emërtimi dhe identifikimi i Kodi CPV- Studime inxhinierike 71335000-5

VLERA E FONDIT LIMIT: 8,330,000 (tetëmilion e treqind e tridhjet mijë) Lek pa TVSH.

Argumentim:

MBI PËRGATITJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE PËRLLOGARITJEN E VLERËS LIMIT
TË KONTRATËS

Në zbatim të urdhërit Nr. 308, date 03/09/2024 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, “Mbi Përgatitjen e Specifikimeve Teknike dhe Përlllogaritjen e Vlerës Limit per objektin e mësipërm, të planifikuar për tu kryer në programet e investimeve.

Grupi i specifikimeve teknike, pasi u njoh me objektin e prokurimit:

1. Dokumenteve sipas Vendimit të Këshillit të Bashkiak nr.195 , datë 22.12.2023, “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2024.
2. Shqyrtoi dokumentat e mësipërme dhe programoi punën për grumbullimin e informacionit, lidhur me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike të punimeve, te hartuar nga: Grupi i Specifikimeve Teknike pjesë e Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike.

Për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës me objekt: **Studim projektimi i projekteve prioritare të infrastrukturës publike në Bashkin e Durrësit**”, grupi i punës u bazua në: akt ekspertizat e thelluara, Detyren e projektimit te hartuar nga specialistet e Derejtoris së Projekteve dhe Infrastruktures Publike dhe VKM Nr.26 date 15.01.2020 ku jepen tarifat si më poshtë;

a) Dokumentimi gjeometrik dhe teknik për objektet pa dokumentacion teknik 150 lekë/m2;

c) Analiza strukturore e thelluar përfshin azhornimin gjeometrik dhe teknik:

i. Provat laboratorike 200 lekë/m² ;

ii. Studimit të thelluar 300 lekë/m²;

ç) Projekti i ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse 200 lekë/m².

Fondi limit i objektit është percaktuar referuar VKM Nr.26 date 15.01.2020 “Për kryerjen e aktekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara” për një sipërfaqe totale rreth 9800 m².

LLOGARITJA E KOSTOS SE PROJEKTIT PER PALLATEVE PER RIFORCIM SIPAS VKM NR.26, DATE.15.01.2020								
NR	OBJEKTE	Nr. KATI	ADRESA	kordinata	G.I.S	SIPERFAQE	KOSTO PROJEKTIT leke/m2	SHUMA
1	Pallati nr 16	5 Kat	Rruga Jahja Ballhysa , lagjia nr 17	N41.320077, E19.455311	3102	1300	850	1,105,000
2	Pallati nr 27	5 Kat	Rruga Dalip Peza , lagjia nr 17	N41.318490, E19.459905	1484/1	700	850	595,000
3	Pallati Mustafa Pash Bushati	5 Kat	Rruga Bajram Tusha, lagjia nr 14	N41.3294120, E19.491185	4911	1600	850	1,360,000
4	Pallati nr 18 (901	5 Kat	Rruga Kristo Sotiri , lagjia nr 18	N41.327276, E19.447882	22378	1650	850	1,402,500
5	Pallati nr 103	5 Kat	Rruga Aleksander Goga , lagjia nr 9	N41.327276, E19.447883	24935	1350	850	1,147,500
6	Pallati nr 196	8 Kat	Rruga Pavaresia	N4130795, E1948866	5513	1800	850	1,530,000
7	Pallati nr 52	5 Kat	Rruga Hysen Kertusha	N411927.98, E192715.48	23005	1400	850	1,190,000
SHUMA E SIPERFAQEVE						9800	850	8,330,000

Mbështetur në rezultatin e sipër nxjerë, Komisioni me unanimitet,

VENDOSI:

Të përcaktojë Vlerën Limit të Kontratës; Për një shumë prej 8,330,000 (tetëmilion e treqind e tridhjet mijë) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Sipas specifikimeve bashkangjitur të hartuara, vendosur dhe përlogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

II. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP-së nr.162/2020, i ndryshuar, nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kritereve të Përgjithshme, (sipas shtojcës9).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së, i ndryshuar, nenin 41, pika 4, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 3.000.000 lek.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së, i ndryshuar, si dhe nenin 43 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj dhe është në përpjesëtim të drejtë me fondin limit të procedurës. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në mbështetje të Ligjit 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", neni 64 Deklarata Tatimore; Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues

ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së i ndryshuar, të nenit 43, pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2024 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 në DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP-së i ndryshuar, si dhe të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. Shlyerja e detyrimeve vendore për vitin 2024 ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendndodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 2 (dy) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 3.000.000 lek. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të

shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar fondit limit sipas nenin 41 pika 3, në kushtet kur kjo procedurë prokurimi është procedurë e thjeshtuar të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar të kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg.

2.3.2 2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Liçensë profesionale për Projektim, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mëposhtme, (sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi) për këto kategori:

2. PROJEKTUES ARKITEKT

Kat- 2/a- Projektim arkitekturor për objekte banimi- objekte industriale- objekte turistike

3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

-Kat-3-a. Objekte civile- industriale turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate

-Kat-3/b-1-Objekte civile-industrial-turistik mbi 5 kate

-Kat-3/c-1.Objekte me shkallë të lartë vështirësie Betonarme – metalike...

-Kat-3/d- Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, muraturë dhe metalike

4. PROJEKTUES INSTALATOR

-Kat-4-c. Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale;

-Kat-4-f. Projektim të sistemeve kundra zjarrit.;

8. PROJEKTUES GJEODET

-Kat-8-a. Rilevime inxhinierike.

9. STUDIM GJEOLIGO INXHINIERIK - HIDROGJEOLOGJIK

-Kat-9-a. Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile-ekonomike deri 5kate.

-Kat -9-b. Studim /gjeologo – inxhinierik I truallit për objektet civile- ekonomike mbi 5 kate.

-Kat -9-d. Studim/Vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve te buta dhe shpateve me qendrueshmeri te ulet.

12. STUDIME TË SIZMOLOGJISË INXHINIERIKE

-Kat- 12-a. Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për klasifikimin gjeosizmik të trojeve.

-Kat- 12-b. Studim/vlerësime gjeologo- sizmike për trojet ku ndërtohen objektet civile, sociale e kulturore.Infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore të të gjitha llojeve, ura, tunele, viadukte etj.

(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).

Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”i ndryshuar me VKM. Nr. 943 date 28.12.2016. Ofertuesit duhet të sjellin Licencat e rinovuara në zbatim të këtij vendimi.

(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Licensat e mesiperme jane vendosur ne kuader te natyres se pergjithshme te punimeve qe priten te realizohen ne kete procedure.

Për arsye të vështirësisë së objekteve të kontratës, rehabilitimi i rezervuarëve në Bashkinë e Durresit, rëndësisë strategjike të tyre në pikëpamjen bujqësore po dhe si pika atraksioni, si dhe problematikat e shfaqura në vite që lidhen me ndërtimin e zonave të banuara poshtë zonave të sigurisë së digave, zona me infrastrukturë ekzistuese mbi dhe nëntokësore, si dhe kërkesave

për garancinë e funksionimit dhe cilësisë së tyre sipas standarteve bashkëkohore, të paisura me elemente inovative të efikasitetit dhe energjisë, vlerësojmë që operatorët ekonomikë duhet të zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm dhe të pranueshëm cilësie.

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet si më poshtë:

<i>KATEGORIA E KËRKUAR</i>	<i>PËRSHKRIMI I KATEGORISË</i>	<i>ARGUMENTIMI</i>
2 – a	Projektim arkitekturor për objekte banimi-objekte industriale-objekte turistike	Bazuar në termat e referencës, shtate pallatet duhen të behet projekti arkitektonik ku të paraqiten të gjitha detajet nderhyrjes si në elementet konstruktiv ashtu dhe në fasade, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
3 - a	Projektim objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.	Bazuar në termat e referencës, godinat e banimit do të jenë pjesë e rikonstruksionit si pjesë përbërëse e skemës së funksionimit të tyre. Gjendja e tyre do të kërkojë elemente strukturalë përforcues ose struktura të reja nga e para, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara për objektet nën 5 kate.
3 - b-1	Projektim objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri mbi 5 kate.	Bazuar në termat e referencës, godinat e banimit do të jenë pjesë e rikonstruksionit si pjesë përbërëse e skemës së funksionimit të tyre. Gjendja e tyre do të kërkojë elemente strukturalë përforcues ose struktura të reja nga e para, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara për objektet mbi 5 kate.
3-c-1	Objekte me shkallë të lartë vështirësie Beton arme – metalike	Bazuar në termat e referencës, objektet që do të rihurtohen do të kërkojnë përfundime konstruktive të domosdoshme të cilat përfshihen në këtë pikë të licencës, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
3-d	Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike;	Bazuar në termat e referencës, objektet që do të rihurtohen përforcimit strukturor do të kërkojnë përfundime konstruktive të domosdoshme, të cilat përfshihen në këtë pikë të licencës, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
4-c	Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale;	Bazuar në termat e referencës, godina pjesë e projektit të rehabilitimit, parashikohet për funksionin që do të kryejnë të kenë sisteme të plota të instalimeve elektrike, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
4-d	Projektim të sistemeve	Bazuar në termat e referencës, godina pjesë e projektit të

	komplekse të telekomunikacionit;	rehabilitimit, parashikohet të jenë të paisur me internet i cili mund të instalohet nëpërmjet kabllove optikë ose sistemit wirlës, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
4-f	Projektim të sistemeve kundra zjarrit;	Bazuar në termat e referencës, godina pjesë e projektit të rehabilitimit, parashikohet të jenë të pajisura me sisteme të mbrojtjes kundra zjarrit këto sipërfaqe ujore mund të shërbejnë si depozita natyrore për shuarjen e zjarreve, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
8 – a	Rilevime inxhinierike	Bazuar në termat e referencës, kemi realizimin e rilevimeve të gjendjes ekzistues të godinës si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
9 – a	Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile – ekonomike deri 5 kate.	Bazuar në termat e referencës, projektimi i godinave të banimit deri 5 kate, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
9 – b	Studim/gjeologo-inxhinierik I truallit për objektet civile-ekonomike mbi 5 kate.	Bazuar në termat e referencës, projektimi i godinave të banimit mbi 5 kate, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
9 – d	Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët	Bazuar në termat e referencës parashikohet të behet një vlerësim dhe nderhyrjet perkatese në bazamentin e objekteve dhe trojeve që e kufizojnë ato. Duke marrë në konsideratë këto fakt vlerësimi gjeologjik për këto kategori është i justifikuar pasi do kemi të bëjmë me sigurimin e qëndrueshmërisë së trojeve.
12 – a	Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për klasifikimin gjeosizmik të trojeve.	Bazuar në termat e referencës, kërkohet domosdoshmërisht vlerësimi dhe studimi sizmik për vlerësimin e kapacitetve për të përcaktuar skemën e ndërhyrjes dhe shkallën e dëmeve, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
12-b	Studim/vlerësime gjeologo- sizmike për trojet ku ndërtohen objektet civile, sociale e kulturore	Bazuar në termat e referencës parashikohet të behet një vlerësim dhe nderhyrjet perkatese në bazamentin e objektit dhe trojeve që e kufizojnë ato. Duke marrë në konsideratë këto fakt vlerësimi sizmik për këto kategori është i justifikuar pasi do kemi të bëjmë me sigurimin e qëndrueshmërisë së trojeve dhe të vetë objekti.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të ketë staf kryesor si drejtues teknik si më poshtë:

Ekspertët kryesorë	Kualifikimet
<p>Drejtues Ekipi / 1 (një) Inxhinier Ndertimi</p>	<p>Kualifikimet dhe aftësitë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Diplomë universitare në Inxhinieri Ndërtimi me profil Strukturist - Liçencë personale në projektim - Përvojë e përgjithshme profesionale: - Të paktën 10 vjet përvojë rajonale/ndërkombëtare në një rol kryesor në projektim/studime për (ri)ndërtimin/rehabilitimin e objekteve të banimit. <p>Përvojë specifike profesionale:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Eksperiencë në projektimin e ndertesave të larta... - Përvoja e mëparshme në kontratat e BE-së do të ishte një avantazh; <p>Detyrat:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëheqësi i Ekipit do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e përgjithshme teknike dhe administrative të detyrës, koordinimin e ekipit të ekspertëve, planifikimin dhe ecurinë e aktiviteteve, koordinimin me palët e interesuara, menaxhimin financiar, raportimin dhe asistencën e përgjithshme teknike në menaxhimin e projektit. - Ai/ajo do të jetë përgjegjës për projektimin strukturor të ndertesave.
<p>1 (një) Inxhinier Hidroteknik</p>	<p>Kualifikimet dhe aftësitë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Diplomë universitare në Inxhinieri Hidroteknike - Liçencë personale në projektim - Një minimum prej 10 vite përvojë rajonale/ndërkombëtare në një rol drejtues të lartë në projektim/studime në projektet e ndertesave. <p>Përvojë specifike profesionale:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përvojë në menaxhimin e të paktën një projekti të përmasave dhe kompleksitetit të ngjashëm në ndertesave. <p>Detyrat:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ai/ajo do të jetë përgjegjës për projektimin e rrjetit të F.U dhe shkarkimi të ujerave të ndotura në ndertes dhe jashtë saj.
<p>1 (një) Arkitekt</p>	<p>Kualifikimet dhe aftësitë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Diplomë universitare në Arkitekturë - Liçencë personale në projektim - Përvojë e përgjithshme profesionale: - Të paktën 10 vjet përvojë rajonale/ndërkombëtare në një rol kryesor në projektim/studime për (ri)ndërtimin/rehabilitimin e ndertesave. <p>Përvojë specifike profesionale:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Eksperiencë në projektimin e ndertesave të banimit , etj... - Përvoja e mëparshme në kontratat e BE-së do të ishte një avantazh; <p>Detyrat:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ai/ajo do të jetë përgjegjës për Projektim e ndertesave dhe

	rikonstruksionin e fasades, etj...
1 (një) Inxhinier Mjedisi	<p>Kualifikimet dhe aftësitë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Diplomë universitare në Inxhinieri Mjedisi - Liçencë personale në projektim <p>Përvojë e përgjithshme profesionale</p> <ul style="list-style-type: none"> - Minimumi 10 vjet përvojë në zhvillimin e studimeve të vlerësimit të ndikimit mjedisor (VNM) . <p>Përvojë specifike profesionale.</p> <p>Detyrat:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ai/ajo do të jetë përgjegjës për gatitjen e raporteve dhe studimeve mjedisore .
1 (një) Inxhinier Gjeodet / Markshajder /Topograf;	<p>Kualifikimet dhe aftësitë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Diplomë universitare në Inxhinieri Gjeodezi/ Markshajder. - Liçence personale ne projektim <p>Përvojë e përgjithshme profesionale</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të paktën 10 vjet përvojë rajonale/ndërkombëtare në një rol kryesor në projektim/studime për (ri)ndërtimin/rehabilitimin e ndertesave te larta. <p>Detyrat:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ai/ajo do të jetë përgjegjës për rilevimin topo gjeodezik te projektit
1 (një) Inxhinier Gjeolog	<p>Kualifikimet dhe aftësitë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Diplomë universitare në Inxhinieri Gjeologji - Liçencë personale në projektim <p>Përvojë e përgjithshme profesionale</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të paktën 10 vjet përvojë rajonale/ndërkombëtare në një rol kryesor në projektim/studime për (ri)ndërtimin/rehabilitimin e ndertesave te larta. <p>Detyrat:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ai/ajo do të jetë përgjegjës për studimin gjeologjik te tojeve
1 (një) Inxhinier Elektrik	<p>Kualifikimet dhe aftësitë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Diplomë universitare në Inxhinieri Elektrike - Liçencë personale në projektim <p>Përvojë e përgjithshme profesionale</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të paktën 10 vjet përvojë rajonale/ndërkombëtare në një rol kryesor në projektim <p>Detyrat:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ai/ajo do të jetë përgjegjës për projektet elektrike e ndertesave te banimit.
1 (një) Inxhinier Mekanik	<p>Kualifikimet dhe aftësitë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Diplomë universitare në Inxhinieri Mekanike - Liçencë personale në projektim <p>Përvojë e përgjithshme profesionale</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të paktën 10 vjet përvojë rajonale/ndërkombëtare në një rol

	<p>kryesor në projektim/studime për (ri)ndërtimin/rehabilitimin e infrastrukturës kulluese dhe vaditëse.</p> <p>Detyrat:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ai/ajo do të jetë përgjegjës për projektet mekanike, ashensorat, etj...
--	--

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, për stafin kryesor operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Diplomë;
- Kontratë pune (e vlefshme) dhe CV;
- Licencat individuale profesionale ne projektim;
- Të figurojnë në licensën e shoqërisë si drejtues teknik.
- Të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë për periudhën **3 muajt e fundit**. Për këtë duhet të dorëzohen listpagesat sipas formatit E-Sig 025/a.

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertes duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit , ku të deklarohet disponimi i punonjësit të sipërcituar.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Operatorët ekonomikë të sukseshëm duhet te dorezoje prane AK, perpara lidhjes të marrëveshjes kuadër, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njësia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Termave të përgjithshme të references për objektet pjesë e kësaj procedure, pjesë e secilave do të jenë të licensuar për shërbimet që priten të realizohen.

- Punimet per sherbimin e projekteve strukturore kane gjithashtu nje volum te rëndesishem, pasi kryesisht parashikohet te kemi realizim te objekteve me shkalle te ndryshme veshtiresie te cilat kerkojne gjykim dhe punime te specializuara ne fushen e projektimit strukturor per te cilen kerkohet dhe staf kryesor. Inxhinieri i profilit Strukturist do te duhet dhe ne projektimin e nderhyrjeve te reja si rrjedhoje gjykohet qe duhet te pakten **1 (nje) inxhinier ndertimi** , pjese e stafit teknik dhe te jete drejtues i grupit te projektimit.
- Punimet per sherbimin e projektimit hidroteknik do te jene volumi me i madh ne kete projekt. Inxhinieri hidroteknik do te jete i pranishme per realizimin e projektit te

furnizimit me uje dhe shkarkimit, etj, si rrjedhoje gjykohet e nevojshme prezenca e te pakten **1 (nje) inxhinieri hidroteknik** si pjese e stafit teknik kryesor.

- Sherbimet per projektimin arkitektonik priten te kene nje volumin te moderuar te projekteve qe realizohen per nivelin e objekteve dhe realizimit te projektit arkitektonik i kesaj procedure, si objekte te nje kategorie te vecante per te cilen gjykohet si e nevojshme prezenca e te pakten **1 (nje) Arkitekti** si staf teknik kryesor.
- Punimet per studimin dhe vleresimin gjeologjik do te jene te pranishme kryesisht ne vleresimin gjeologjik per vlersimin bazamentit, si rrjedhoje gjykohet si e nevojshme prezenca e te pakten **1 nje inxhinieri gjeolog** si staf kryesor.
- Punimet per sherbimin e projektimit topografik do te jene nje ze i rendesishem ne realizimin e projekteve qe parashikohen te kene dhe volume te konsiderueshme te punimeve topografike si rrjedhoje gjykohet si e nevojshme prezenca e te pakten **1 (nje) gjeodet** si pjese e stafit kryesor.
- Punimet per sherbimet e projektimit te sistemeve mekanike do te jene dhe pasqyrohen me ane te sistemeve te projektimit te ashensoreve, etj, si rrjedhoje gjykohet si e nevojshme prezenca e te pakten **1 (nje) inxhinieri mekanik**, si pjese e stafit kryesor.
- Punimet per sherbimin e projektimit te sistemeve elektrike parashikohen bazuar ne termat e references, si rrjedhoje gjykohet si e nevojshme prezenca e te pakten **1 (nje) inxhinieri elektrik**, si pjese e stafit kryesor.
- Punimet per sherbimin e projektimit te studimeve mjedisore parashikohen bazuar ne termat e references, si rrjedhoje gjykohet si e nevojshme prezenca e te pakten **1 (nje) inxhinieri Mjedisi**, si pjese e stafit kryesor.

Stafi kryesor i kerkuar me siper duhet te disponoje dhe licencat personale te projektimit.

2.3.3 Operatori Ekonomik ofertues duhet te kete si staf mbështetës si më poshtë:

Stafe ndimes	Kualifikimet
1 (një) Inxhinier Hidroteknik	Kualifikimet dhe aftësitë - Diplomë universitare në Inxhinieri Hidroteknike - Liçencë personale në projektim - CV - Referencë
1 (një) Arkitekt	Kualifikimet dhe aftësitë - Diplomë universitare në Arkitekture - Liçencë personale në projektim - CV - Referencë
2 (dy) Inxhinier Ndertimi profili strukturist	Kualifikimet dhe aftësitë - Diplomë universitare në Inxhinieri Ndertimi - Liçencë personale në projektim - CV - Referencë

1 (një) Inxhinier Gjeodet	Kualifikimet dhe aftësitë - Diplomë universitare në Inxhinieri Gjeodet - Liçencë personale në projektim - CV - Referencë
1 (një) Inxhinier Gjeoteknik	Kualifikimet dhe aftësitë - Diplomë universitare në Inxhinieri Gjeoteknike - Liçencë personale në projektim - CV - Referencë
1 (një) punonjës të pajisur me certificate lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis	Kualifikimet dhe aftësitë - Diplomë universitare në Inxhinieri - Të ketë Çertifikatën e ekspertit nga Ministria e Mjedisit; Përvojë e përgjithshme profesionale - Të paktën përvojë rajonale/ndërkombëtare ne studime të vlerësimit të ndikimit mjedisor (VNM) Detyrat: - Ai/ajo do të jetë përgjegjës për gatitjen e VNM-së në kuadër të studim projektim .

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, për stafin mbështetës operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Diplomë;
- Kontratë pune (e vlefshme për gjithë periudhën e angazhimit për këtë objekt);

Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit, ku të deklarohet disponimi i punonjësve të sipërcituar.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Operatorët ekonomikë të sukseshëm duhet të dorëzojnë pranë AK, përpara lidhjes të marrëveshjes kuadër, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njesia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Termave të referencës, natyres së përgjithshme të shërbimeve që priten të ofrohen. Meqenese kemi të bëjmë me rikonstrukcion të një objekti kompleks sic janë digat dhe rezervuarët përkatës prezencë e stafit të mesipër është gjykuar si e domosdoshme dhe e nevojshme për një shpërndarje dhe efikasitet sa më të madh në realizimin e shërbimeve konkretisht;

- Punimet për shërbimin e projektimit hidroteknik do të jenë volumi më i madh në këtë projekt. Inxhinierët hidroteknik do të jenë të pranishëm për realizimin e projektit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ndërtësës, si rrjedhojë gjykohej e nevojshme prezencë e të paktën **1 (një) inxhinieri hidroteknik** si pjesë e stafit ndihmës.
- Punimet për shërbimin e projekteve arkitektonike do të jenë volumi i madh në këtë projekt. Arkitekti do të jenë të pranishëm për realizimin e projektit të objekteve shumëkateshe të ndërtësës, si rrjedhojë gjykohej e nevojshme prezencë e të paktën **1 (një) Arkitekti** si pjesë e stafit ndihmës.
- Punimet për shërbimin e projekteve strukturore kanë gjithashtu një volum të rëndësishëm, pasi kryesisht parashikohet të kemi realizim të objekteve me shkallë të ndryshme vështirësie të cilat kërkojnë gjykim dhe punime të specializuara në fushën e projektimit strukturor për të cilën kërkohet dhe staf ndihmës. Inxhinieri i profilit Strukturist do të duhet dhe në projektimin e nderhyrjeve të reja si rrjedhojë gjykohej që duhet të paktën **2 (dy) inxhinier ndërtimi**, pjesë e stafit ndihmës.
- Punimet për shërbimet që ofrohen nga inxhinieri gjeoteknik bazuar në punime dhe vlerësime të inxhinierise, vlerësimet gjeoteknike të trojeve do të jenë të nevojshme të realizohen, konkretisht në këto objekte meqenese kemi ndërtësë që do të rikonstruktohen si dhe vlerësim dhe rikonstrukcion themeleve është nevojë e prezencës së **1 një specialisti inxhinier gjeoteknik** si staf ndihmës për kategorinë e sipërcituar për vlerësimin gjeoteknik.
- Punimet për shërbimin e projektimit topografik do të jenë një zë i rëndësishëm në realizimin e projekteve që parashikohen të kenë dhe volume të konsiderueshme të punimeve topografike si rrjedhojë gjykohej si e nevojshme prezencë e të paktën **1 (një) gjeodet/markkshajder/topograf** si pjesë e stafit ndihmës.
- **1 (një) punonjës të pajisur me certificate lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis**, gjykohej si i domosdoshëm si pjesë e stafit ndihmës për realizimin dhe aplikimin në sistemin e VNM (Vlerësimet e ndikimit në Mjedis) për projektet që do të realizohen.

2.3.4 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës sipas periudhës së kërkuar të deklaruar, të vërtetuar me:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhën e kërkuar të deklaruar
- b) Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar të deklaruar.

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit, ku të deklarohet disponimi i punonjësve të sipërcituar.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Operatorët ekonomikë të sukseshëm duhet të dorëzojnë pranë AK, përpara lidhjes të marrëveshjes kuadër, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë: për përcaktimin e fuqisë punëtore minimale të kërkuar argumentojmë se jemi bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Termave të Referencës. *Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë, tregon besueshmëri për autoritetin. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Numri I mesiper perkon me stafin që pritet të jete I angazhuar ne keto procedura.*

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të jete i pajisur dhe të paraqese Certifikatat të pershtatshme **ose ekuivalentet e tyre** për objektin e prokurimit si më poshte:

- a) ISO 9001: 2015, Per menaxhimin e cilesise;
- b) ISO 14001: 2015, Per menaxhimin e cilesise se mjedisit;
- c) ISO 50001:2018, Sistemi i Menaxhimit të Energjisë;

Shënim: Në rastet e Bashkimit të Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqese certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizojë sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

Argumentimi: *Kerkesat e mesiperme jane vendosur bazuar ne Nenin 79, pika 1 te Ligjit Nr. 162/2020, “Per prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të*

Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”

Certifikatat e cilesise jane bazuar ne perputhje jane ne perputhje me natyren dhe objektin e kontrates qe prokurohet.

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera:

- *1(një) Pajisje për matjet gjeodezike Total Station/GPS.*
- *1(një) Automjete transporti.*

Për plotësimin e kësaj kërkesë duhet të paraqitet një dokument i cili vërteton pronësinë ose aktin e marrjes me qera të tyre si dhe skeda teknike e këtyre pajisjeve.

Për automjetin kur është në pronësi të paraqitet certifikata e pronësisë, leja e qarkullimit, siguracioni dhe certifikata e kontrollit teknik. Për automjetet me qira krahas dokumentacionit të mësipërm të paraqitet edhe kontrata noteriale e qirasë ku perfshihet periudha e shërbimit.

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.3.7 Operatori ekonomik, duhet te paraqesë nje CV te shoqerise dhe stafit te propozuar, ku te perfshihen kontrata te ngjashme, Referenca/Vertetime, Certifikata ISO, Organigrame, Metodologji, Trajnime, Kualifikime, per qellime te vleresimit.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik.

Argumentimi: Në bazë të pikës 2/b dhe 5 të nenit të 87, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 45, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, 2. *Oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenin 88 të këtij ligji, dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.*

Kritere të tilla mund të përfshijnë: organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës;

Autoriteti ose enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.

Nëse përcaktimi i shkallës së rëndësisë nuk është i mundur për arsye objektive, autoriteti ose enti kontraktor i paraqet kriteret sipas rëndësisë në rend zbritës.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Specifikimet teknike të përfshira në termat e referencës janë hartuar në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 3 date 15.02.2001 “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Udhëzimit nr.2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve te ndërtimit”.

Shënim: Per me shume informacion rreth dokumentacionit, referohuni procedures me objekt: " Sistemi i trajtimit te ujrave te zeza ne Lagjen e re Spitalle ":

Sipas termave të referencës dhe procesverbalit për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim bashkëngjitur të hartuar, vendosur dhe përlllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinal ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

NJOFTIMI I SHKURTUAR I KONTRATËS

(Për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor, për publikim në

Buletinin e Njoftimeve Publike)

1 Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

Emri Bashkia Durrës
Adresa Sheshi "Liria", Qyteti Durrës
Tel/Faks 052 22 23 10
E-mail info@durres.gov.al
Ueb-faqe www.durres.gov.al

2. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë e Hapur e Thjeshtuar, Shërbim

3. Numri i referencës së procedurës/Lotit: REF-23569-10-09-2024

4. Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër: "Studim projektimi i projekteve prioritare të infrastrukturës publike në Bashkin e Durrësit".

5. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Emërtimi dhe identifikimi i Kodi CPV-Studime inxhinierike 71335000-5

6. Fondi limit: : 8,330,000 (tetë milion e treqind e tridhjetë mijë) Lek pa TVSH.

7. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose **afati për zbatimin e saj: 84** (tetëdhjetë e katër) dit

8. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 21.10.2024, ora 10.00..

9. Procedurë e Rishpallur:

Po



Jo

X

Nëse është një procedurë e rishpallur, ju lutemi plotësoni të dhënat identifikuese të procedurës së anuluar:

a) Numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik të procedurës së anuluar të prokurimit _____

b) Objekti i prokurimit të procedurës së anuluar të prokurimit _____

c) Fondi limit i procedurës së anuluar të prokurimit _____ (shuma , monedha)

Dokumentet e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anëtarët e njësisë kane akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP(www.app.gov.al).

Njësia e Prokurimit